



Prishtinë: 24.09.2018
Kodi i ZRRE-së: V_1039_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1854_08_18**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **20.09.2018**.

në seancën e mbajtur më datë **24.09.2018**, nxori këtë:

V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit N. R. nga Prishtina me shifër të konsumatorit: DPR – 14888 ndaj vendimit të DMK-së, si e pa bazuar.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK_V_1854_08_18** i datës 27.08.2018.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 24.08.2018 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkalës së parë. Konsumatori në ankesën e tij ka theksuar se ai ka parashtruar ankesë në KESCO nën dyshimin e matjes së jo të saktë të njehsorit elektrik për shkak se faturat e energjisë elektrike kanë arritur shumë të larta. Konsumatori në ankesën e tij ka theksuar se gjatë inspektimit të pikës matëse punëtorët e autorizuar të KEDS-it kanë inspektuar pikën matëse dhe gjatë inspektimit kanë theksuar se një nga fqinjët është kyçur në njehsorin tuaj, por që ky konstatim nuk është evidentuar në procesverbal. Konsumatori në ankesën e ti gjithashtu ka theksuar se pas kërkesës së tij ai ka parashtruar ankesë në KEDS dhe se KEDS i ka ndërruar njehsorin elektrik.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 24.09.2018 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të konsumatorit se ai ka dyshuar në saktësinë e njehsorit elektrik, Bordi i ZRRE-së thekson se gjatë analizës së bërë shkresave të lëndës ka vërejtur se bazuar në ankesën e konsumatorit, punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse me datë 29.01.2015 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, ku kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr.04674862, dhe kanë evidentuar që gjendja e shpenzimeve është e pa lexueshme, si dhe



kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 63980599 me gjendje TL=000000 kWh dhe TU=000000 kWh, si dhe në këtë procesverbal nuk është evidentuar se njehsori elektrik ka ndonjë defekt.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar me kujdes edhe shpenzimin e energjisë elektrike të konsumatorit dhe se bazuar në analizën e përgjithshme të energjisë elektrike konstatohet se konsumatori ka lexim dhe faturim të rregullt të shpenzimeve mujore. Bazuar në shpenzimin e energjisë elektrike të konsumatorit për periudha të njëjta kohore është vërejtur se: me njehsorin elektrik nr.04674862 prej periudhës 02/2013 deri në periudhën 01/2015 mesatarja mujore e shpenzimit është 878 kWh/muaj, si dhe periudhën 02/2015 deri në periudhën 01/2017 mesatarja mujore e shpenzimit është 693 kWh/muaj. Pra nga kjo shihet qartë se shpenzimi i energjisë elektrike i konsumatorit si para dyshimit të konsumatorit ashtu edhe pas nuk ka ndonjë ndryshim të madh e cila do të duhet të veçohej.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të konsumatorit se punëtorët e autorizuar të KEDS-it gjatë inspektimit të pikës matëse të konsumatorit kanë theksuar se një nga fqinjët është kyçur në njehsorin tuaj, Bordi i ZRRE-së thekson se ka analizuar disa procesverbale të inspektimit të KEDS-it e në të cilat në disa procesverbale nga punëtorët e autorizuar të inspektimit është konstatuar se kanë pasur qasje në pikën matëse të konsumatorit (procesverbalet e inspektimit nr.1399468 e datës 14.12.2015 dhe nr.1995145 e datës 06.04.2016). Po ashtu Bordi i ZRRE-së ka analizuar edhe procesverbalet e inspektimit nr.1814046 të datës 08.06.2016 dhe nr.1706418 e datës 11.06.2016 dhe ku në procesverbale është evidentuar gjendja e shpenzimeve të konsumatorit në njehsorin elektrik nr.63980599 prej TL=005046 kWh dhe TU=005957 kWh dhe se shpenzimet e konsumatorit të faturuara në programin e faturimit (ang. Customer Care Package - "CCP") për periudhën maj 2016 përputhen me të dhënat e evidentuar në procesverbalin e inspektimit. Pra Bordi i ZRRE-së thekson se gjatë analizës së bërë të gjitha procesverbaleve të inspektimit në asnjërën nga procesverbalet nuk është konstatuar se në njehsorin e konsumatorit ka pasur kyçje ilegale.

Bordi i ZRRE-së thekson se gjatë analizës së bërë të gjitha shkresave të lëndës ka vërejtur se, KEDS/KESCO kanë respektuar nenin 28 paragrafin 1 dhe 2 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, ku thuhet se: " **1. Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shfrytëzuar dhe për taksat e tjera, në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme). 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Furnizuesi ose Operatori i Sistemit për konsumatorët me tarifa të rregulluara në bazë të tarifave të miratuara nga ZRRE-ja, dhe për konsumatorët e kualifikuar (me çmime të parregulluara) ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim".**

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 24.09.2018 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Konsumatorit N. R.
- KESCO-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.